



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 373/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Ademaj në cilisin e Zyrtarit të lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Istog, për shkak të mbajtjes së tubimit elektoral pa paralajmërim, në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Bashkim Ademaj Zyrtar i lartë Komunal Zgjedhor (ZLKZ), dega në Istog.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 29.10.2013, nga Bashkim Ademaj (ZLKZ) dega në Istog, në të cilën theksohet se me datë 19.10.2013 në Restorant Butrinti në Istog është mbajtur një tubim politik i pa paralajmëruar i Forumit të Gruas të AAK-së ku kanë marrë pjesë rreth (gjashtëqindë) 600 persona, ku kanë prezantuar programin e partisë nga kandidatët e AAK-së thuhet në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se subjekti politik AAK ka mbajtur tubim elektoral pa paralajmërim PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse. Prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa

Anr. 373/2013 më datën 31.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*